



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**KËSHILLI BASHKIAK BERAT**  
**Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale**

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda: "Relacion për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë  
Gjinore 2026-2028"**

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në nenin 113 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", .

Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", i ndryshuar;

Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar; Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021—2030;

Udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për integrimin e barazisë gjinore në politikat vendore;

Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW);

**Situata aktuale e funksionit**(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Në Bashkinë Berat, sfidat lidhur me barazinë gjinore mbeten të dukshme në disa aspekte të jetës sociale dhe ekonomike, si:

- përfaqësimi i kufizuar i grave në vendimmarrje,
- pjesëmarrje më e ulët në tregun e punës,
- ndarja e pabarabartë e roleve në familje,
- dhuna me bazë gjinore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ky Plan është hartuar në mënyrë pjesëmarrëse, në bashkëpunim me përfaqësues të komunitetit, institucione vendore, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë zhvillimi. Ai mbështetet në të dhëna konkrete dhe identifikon objektiva strategjike si:

- forcimi i kapaciteteve të strukturave vendore për integrimin gjinor,
- promovimi i punësimit të grave dhe grave sipërmarrëse,
- përmirësimi i aksesit në shërbime të ndjeshme gjinore,
- rritja e ndërgjegjësimit në komunitet për çështjet e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës.

#### **Situata financiare :**

Çdo masë do të ketë planifikim buxhetor të integruar sipas viteve, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë dhe zbatueshmërisë së planit Duke qenë se barazia gjinore është një parim themelor për zhvillimin demokratik, përfshirës dhe të qëndrueshëm të bashkisë, si dhe një angazhim kombëtar dhe ndërkombëtar i Shqipërisë, kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i Beratit i Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026— 2028.

Miratimi i këtij dokumenti do t'i japë bashkisë Berat një bazë të fortë për veprime konkrete në drejtim të përmirësimit të jetës së grave dhe burrave në komunitet..

#### **Drejtoria / Sektori përgjegjës**

Drejtoria e Shërbimit Social, **Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe te Ardhurave**, **Drejtoria Juridike** , **Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve**, **Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse**, **Drejtoria e Planifikimit urban, lejeve dhe monitorimit te investimeve**, **Drejtoria e Taksave dhe Tarifave**, **Drejtoria e Emergjencave**, **Pronave**, **Transportit dhe Shërbimeve**, **Drejtoria e Arsimit**. **Drejtoria e Integritit European dhe Zhvillimit Strategjik**, **Drejtoria e Arsimit**, **Kultures dhe Rinisë**, **Agjensia e Shërbimeve Publike**, **Drejtoria e Bujqësisë**, **Adiministrimit të Pyjeve**, **Ujërave dhe Shërbimit Veterinar**.

#### **Impakti social / grupet që preken:**

Individet të cilët janë të prekur nga dallimet gjinore

#### **A është objekt i konsultimit publik:**

Mund te behet konsultimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**”, i mbledhur në datën 29 /04/2026, shqyrtoi projekt vendimin “**Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026-2028**”

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

### **VENDOSI**

1. Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026-2028.

**Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**

**Krenar Suku- Kryetar i Komisionit**

**Anisa Veliu –N/Kryetar**

**Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit**

**Fatjon Elezi-Anëtar**

**Rovena Cuku-Anëtar**

**Muharem Hoxha-Anëtar**

**Shyqyri Dura-Anëtar**

Datë 29 /04/2026